



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

R A P O R T

Konferenca Rajonale për Shërbimet Sociale rreth decentralizimit të shërbimeve sociale

U majtë më 06 Dhjetor 2011

“ Emerald Hotel ” Prishtinë



Hyrje :

Më date 06 Dhjetor 2011 Asociacioni I Komunave të Kosovës organizoi Konferencën Rajonale për Shërbime Sociale, kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv I AKK-së z. Sazan Ibrahimimi dhe menaxheri i programit z. Ertan Munoglu, hapjen dhe mirëseardhjen e Konferencës e bëri kryetari I Asociacionit z. Bajrush Xhemaili, zv. Ministri i MAPL-së z. Bastri Musë Murati, si dhe Drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale z. Muhamet Gjocaj.

Në Këtë Konferencë morën pjesë përfaqësues nga niveli qendror dhe lokal nga vendet në rajon si : Bullgaria, Hungaria dhe Kroacia, morën pjesë Drejtorët Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorë Komunal për Buxhet dhe Financa, Drejtorë të Qendrave për Punë Sociale, përfaqësues nga Departamenti I Mirëqenies sociale – MPMS-ja, OJQ të cilat ofrojnë shërbime sociale si: Handikos, Amiqi de Bambini, Terres des Homes, shtëpia e pleqve –Prishtinë, Qendra për Mbrojtjen e grave dhe Fëmijëve, dhe OJQ të tjera, përfaqësues nga projekti I DFID-it, organizata ndërkombëtare e punës Ilo-Ipec përfaqësues nga Komisioni Evropian, përfaqësues nga zyra ndërlidhëse WYG- ZNKE –ja, përfaqësues nga GIZ, si dhe përfaqësues nga Departamenti I Buxhetit Qendror – Ministria e Financave.

Qëllimi :

Konferenca rajonale e shërbimeve sociale kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave nga vendet rajonale të decentralizuara në aspekt të ofrimit të shërbimeve sociale.

Nga fjala hyrëse e kryetarit të AKK-së u prezantua qëllimi I Konferencës si dhe mbështetja e Akk-së nga projekti I DFID-it me qëllim të ngritjes së kapaciteteve komunale për ofrimin e shërbimeve sociale sa më adekuate dhe sa më afër qytetarit të Kosovës.

Prezenca e përfaqësuesve rajonal nga Bullgaria, Hungaria dhe Kroacia kishte për qëllim shkëmbimin e eksperiencave, vështirësive, sfidave, në të cilat këto vende janë përballur gjatë procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, si dhe shkëmbimi I metodave të punës drejtë ofrimit më të mirë të shërbimeve sociale për qytetarin .

Përmbledhje e prezantimeve

Prezantimi nga Drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale z. Muhamet Gjocaj.

- Z. Gjoca prezantoi sistemin e mbrojtjes sociale në Kosovë duke përfshirë modelin e mbrojtjes sociale e cila ende është në tranzicion, financimi i cili bëhet nga fondet publike të ndara nga niveli qendrorë i qeverisë, gjendja aktuale e varfërisë, papunësia, politikat dhe programet e mbrojtjes sociale, shërbimet sociale profesionale dhe format e mbrojtjes, legjislacioni, përgjegjësit e MPMS-së në shërbime sociale duke përfshirë organizimin e përgjithshëm të ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, koordinimin, inspektimin, ofrimin e këshillave dhe udhëzimin për OJQ-ët që ofrojnë shërbime sociale, financimin e pagesave të përfitimeve kesh të skemave dhe ndihmat sociale. U prezantuan edhe përgjegjësit e aktorëve tjerë të involvuar si : Përgjegjësit e Komunave në ofrimin e

shërbimeve sociale, përgjegjësit e MAPL-së dhe MF, mënyra e financimit pas procesit të decentralizimit, qasja e planifikuar për financim në vitin 2013, mbështetja nga donatorët, si dhe planet për të ardhme (për më shumë detaje ju lutem gjeni prezantimin e bashkangjitur).

- Prezantim nga Kryesuesi i Kolegjiut për Mirëqenie Sociale z. Bashkim Hyseni. Ky przanrim përmban punën e deri tanishme të Kolegjiut për Mirëqenie Sociale duke përfshirë aktivitetet e deri tanishme (punëtorive) me Drejtorit Komunale për Mirëqenie Sociale, Drejtorive për Buxhet dhe Financa, Drejtorëve të Qendrave për Punë Sociale, të cilat kanë pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe përgjegjësi, zhvillimet politike në drejtim të decentralizimit, dhe sfidat rreth hapave konkret në decentralizim, në këtë prezantim janë paraqitur dhe mbështetja financiare dhe profesionale e projektit të DFID-it dhe ZNKE-së (për më shumë informata gjeni të bashkangjitur prezantimin).
- Prezantim nga Romana Galic – Zyra për Mbrojtjen Sociale dhe për Persona me Aftësi të kufizuar në Zagreb/ Kroacia.

Republika e Kroacisë është përcaktuar me kushtetutë si shtet social, ku synon kalimin e rreziqeve të jetës, standardizimin e mundësive në jetë dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. U prezantua sistemi i decentralizimit të kujdesit social, memorandumi i përbashkët social i Republikës së Kroacisë, Ligji për Mirëqenie Sociale, mirëqenia sociale në qytetin e Zagrebit, politikat sociale, ndihmat financiare, ndihma natyrale, ndihma tjera bazuar në Programin e Politikës Sociale, numri i institucioneve të kujdesit social, dhe organizatat e shoqërisë civile (për më shumë detaje se si ofrohen këto shërbime sociale gjeni të bashkangjitur prezantimin).

- Prezantim nga Hristo Bozov – Nën Kryetar nga Komuna Varna – Bullgari.

Kujdesi social dhe shëndetësor në nivel lokal në Bullgari mundë të ofrohet nga Qeveria, Komunitet, entitetet individuale (nga ligji apo nga persona juridik), nga institucionet speciale në Komunitet etj. Nga ky prezantim janë paraqitur edhe reforma të tjera të tranzicionit nga kujdesi institucional për shërbimet e ofruara në komunitetet (viti 2003), shërbimet sociale të deleguara, shërbimet sociale në Komunitet për fëmijët dhe të rriturit, institucionet e posaçme për të moshuarit, shërbimet të cilat ofrohen nga Komunitet, masat Komunale për mbrojtjen sociale , kujdesi për të rriturit dhe njerëzit me aftësi të kufizuara (ku është përgjegjësi e Komunave), qasje në arsim, programet për Romët si dhe kujdesi i fëmijëve është përgjegjësi e plotë Komunale. *(për më shumë detaje gjejeni prezantimin e bashkangjitur).*

- Prezantim nga Margit Kynik – Eksperte për shërbime sociale në Hungari

Procesi I decentralizimit të shërbimeve sociale në Hungari ka filluar qysh në vitin 1990, fillimisht me decentralizimin e administratës publike, si dhe me situatën e vetëqeverisjes lokale gjatë viteve 1990. Në këtë prezantim janë paraqitur ofrimi I shërbimeve sociale dhe kujdesi I fëmijëve në Hungari, aspekti I financiar për të ofruar këto shërbime, përvojat e viteve 1990 për shërbimet sociale dhe decentralizimin, sistemet qendrore për ri-përqendrim, ndikimet në ofrimin e shërbimit social dhe të kujdesit të fëmijëve, sfidat

organizative, si dhe sfidat e një të ardhme të afërt. (për më shumë informata gjeni të bashkangjitur prezantimin).

Komente

Përfundimisht pas prezantimeve ka pasur disa komente për këtë proces, si nga OJQ -ët po ashtu edhe nga ministritë dhe nga përfaqësuesit ndërkombëtar, siç janë :

- Si bëhet Kontraktimi I OJQ –ve ? (në Hungari kontraktimi I OJQ –ve gjatë viteve 1990 ka qenë mundësi ligjore për OJQ- ët, janë përcaktuar përmbushja e kriterëve si dhe licencimi I ofrimit të shërbimeve, dhe përcaktimi I këtyre shërbimeve është bërë në bazë të Ligjit për Shërbime Sociale Familjare (nëse OJQ-ja ka përmbushur kriteret për licencim, është licencuar).
- Nga cili institucion bëhet sigurimi i objekteve për Ojq –ët të cilat ofrojnë shërbime sociale në Hungari ? (27 % e shërbimeve sociale ofrohen nga Ojq-ët në Hungari, dhe sigurimi i objekteve bëhet nga vetë Ojq-ët, ndërsa Qeveria i licencon dhe i financon.
- Sa është totali I buxhetit të alokuar për shërbime sociale në Bullgari ? (Shërbimet sociale delegohen nga aktivitetet e qeverisë, dhe janë financuar nga buxheti I shtetit, buxhetet komunale që përcaktohen çdo vit nga vendimi I këshillit të Ministrave, ndërsa shuma totale e buxhetit e cila është ndarë për shërbimet sociale në nivel lokal është 120 milion euro).
- Pse është bërë rikonzentrimi i kompetencave në nivel lokal në Hungari ? (ka qenë vendimit politik);
- Nga kush bëhet zgjedhja e Ojq-ve të cilat sigurojnë shërbime sociale kualitative, dhe siç dihet ka edhe keqpërdorime ? (Në Hungari çdo 4 vite bëhet vlerësimi dhe selektimi nga Komuniteti, dhe financimi i kontraktimit bëhet nga Qeveria, sepse është më i lirë, mirëpo kualiteti i ofrimit të shërbimeve sociale nuk ndryshon nga i Institucionet shtetëror, mirëpo zgjedhën Ojq-ët sepse janë më kreative.

Konferenca rajonale për shërbimet sociale rezultoi me shumë komente, dhe disa risi që u sollën nga përfaqësuesit e vendeve rajonale, ku u shkëmbyen eksperiencat dhe përvojat në lidhje me procesin e decentralizimit.